



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:098831
Datë: 10.10.2024
Numri i dokumentit: 06279500

C.nr.869/21

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Shyqri Hoxha, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A.L., A.B.1, A.B.2, H.R. dhe V.Sh. të gjithë nga Prizreni, të cilët i përfaqësojnë av.B.K. dhe av.F.G. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e pagave jubilarë, jashtë seancës gjyqësore, me datë 10 tetor 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.L. nga Prizreni.
- II. DETYROHET e paditura, Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, që paditëses A.L. në emër të kompensimit të pagës jubilarë për 40 vite përvojë pune, në vlerë të 150% të një page bazë (vlera e pagës bazë 265.63 euro), t'ia kompensoj shumën prej 398,44 (treqind e nëntëdhjetë e tetë euro e katërdhjetë e katër cent) euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- III. REFUZOHET pjesërisht si e pabazuar kërkesëpadia e palës paditëse mbi shumën e aprovuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, përkatësisht shuma prej 98,67 euro.
- IV. Konstatohet e tëhequr padia e paditësve A.B.1, A.B.2, H.R. dhe V.Sh. nga Prizreni.
- V. DETYROHET e paditura që paditëses A.L. t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej **124 euro**, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm

A r s y e t i m

Paditësit përmes të autorizuarëve të tyre av.B.K. dhe av.F.G. nga Prizreni, në këtë Gjykatë me datën 24.05.2021 kanë parashtruar padi për kompesimin e pagave jubilarë, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit.

Në padi, të autorizuarit e paditësve kanë theksuar se paditësit janë të punësuar sipas kontratës së punës në SH.F.M.U. "Lekë Dukagjini" në Prizren dhe kanë mbi 10 vite përvojë të punës. Theksojnë se kanë bërë kërkesa të vazhdueshme për pagesën e këtyre pagave jubilarë por nuk kanë marr asnjë përgjigje. Paditësi i plotëson kushtet e përfitimit të kompensimit të pagës jubilarë sipas kushteve të parapara me Nenin 35 par.8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Andaj, paditësit me padi kërkojnë që në emër të kompensimit të pagës jubilarë të kompensohen.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Ka theksuar se paditësit nuk kanë ofruar prova që janë anëtar të sindikatës dhe i kanë kaluar procedurat administrative dhe nuk i ka shtjerrur mjetet e brendshme të ankimit në kuptim të nenit 78 dhe 79 të Ligjit të Punës. Gjithashtu thekson se në mungesë të alokimit të mjeteve nga Ministria e Arsimit, e paditura nuk mund të veproj në kundërshtim me planifikimin buxhetor, andaj nga të gjitha të cekurat ka kërkuar që gjykata të nxjerr aktgjykim dhe të refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet i procedurës kontestimore i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 dhe nenin 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, në SH.F.M.U. "Lekë Dukagjini", në Prizren, e që ky fakt gjen edhe mbështetje në bazë të vërtetimit të lëshuara nga e paditura.

Gjykata përmes vërtetimit të lëshuara nga ana e të paditurës, ka vërtetuar faktin se paditësja A.L. e lindur me datë 12.12.1958, ka filluar punën me datë 17.04.1980, si bibliotekiste dhe vazhdon ende të të punojë

Vërtetimin e lartcekura, Gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se "*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*". Andaj meqë ky dokument është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilat edhe si të tilla janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, ashtu që vërtetimet e lëshuara nga ana e SH.F.M.U. "Lekë Dukagjini", në Prizren, si provë me të cilat vërtetohet fakti lidhur me ditët e prezencës në punë të paditësve, gjykata ia fali besimin e plotë.

Po ashtu në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021, e më saktësisht në dispozitën 35 paragrafi 8, të KKAK-së është paraparë se: Punëtorët

(anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar në vlerë: *për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë, për 20 vjet vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë, për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë, për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150% të një page bazë.*

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditëses si punëtor të arsimit t'ia paguaj kompensimin për pagën jubilarë, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës, duke i njohur shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket pjesës refuzuese të kërkesëpadisë së palës paditëse, gjykata erdh në përfundim se pala paditëse nuk realizon pagën bazë në lartësi prej 331.61 eurove, por e njëjta duke marrë parasysh se për pozitën e bibliotekistës pranë Shkollave Fillore realizojnë pagën bazë prej 265,63 euro , andaj të njëjtës për si kompensim i pagës jubilarë për 40 vjetorin e punës i takon 150% e pagës bazë që i bie shuma aprovuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se "kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë". Po ashtu, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe në kuptim të nenit 399 par. 1 të LPK-së, pasi që pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses është e pabazuar në dispozita ligjore. Në këtë drejtim, sipas nenit 399 par. 1 të LPK-së parashihet që "kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin merititor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia".

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (24.05.2021), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

I autorizuari palëve paditëses me parashtrësën e datë 03 tetor 2024, e ka njoftuar gjykatën se e tërheq padinë për të gjithë paditësit e tjerë përveq paditëses A.L. për të cilën ka cekur që të vazhdon procedura sipas padisë, andaj gjykata në kuptim të nenti 261 paragrafi 2 të LPK-së, vendosi si në paragrafin nën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së lidhur me Rregulloren për Tarifat e Avokatëve e datës 18 mars 2017, lartësia e shpenzimeve i referohet 104 euro, për përpilimin e padisë, si dhe për taksën gjyqësore shumë prej 20.00 euro, gjithsej shumë prej 124.00 euro. Gjykata këto shpenzime ia ka njohur palës paditëse për të cilën ka vendosur me aktgjykim merititor për kërkesën e saj.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e cekura më lartë.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.869/21, datë 10 tetor 2024

Gj y q t a r i
Shyqri Hoxha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër vendosjen si në pikën I, II, III dhe V të dispozitivit të këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit, pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Për vendosjen si në pikën IV të dispozitivit të këtioj aktgjykimi, në kuptim të nenit 261 paragrafi 4 të LPK-së nuk është e lejuar ankesa.